

VENDIM
Nr.220, datë 9.10.2008

PËR MOSMIRATIMIN E DY ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 21 të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar dhe të neneve 55 pika 1 e 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në propozimin e Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të mos miratojë propozimin e Presidentit të Republikës, sipas dekretit nr.5769, datë 23.6.2008, për zgjedhjen e zotit Burhan Malevi në detyrën e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës.

II. Të mos miratojë propozimin e Presidentit të Republikës, sipas dekretit nr.5789, datë 30.6.2008, për zgjedhjen e zotit Engjëll Skreli në detyrën e anëtarit të Komisionit të Konkurrencës.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)